



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

Klinë, dt.11.04.2024

01-457-12566/24

Duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në gazetën zyrtare, nr.28 me dt. 04.06.2008, dispozitat e nenit 9 të Rregullores së MF nr.07/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, si dhe duke marrë parasysh Thirrjen për financim të OJQ-ve të datës 21.02.2024, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 11.04.2024, mori;

V E N D I M

Për formimin e komisionit të ankesave lidhur me vlerësimin e kërkesave për financim të OJQ-ve

- FORMOHET**, komisioni i ankesave për shqyrtimin e ankesave eventuale ndaj vendimeve për mos kualifikim apo ndarje të mbështetjes financiare, sipas thirrjes publike për financim të OJQ-ve të datës 21.02.2023. Përbërja e komisionit është, si në vijim:
 - 1.1 Alban Gashi
 - 1.2 Elbarim Morina
 - 1.3 Taulant Berisha
- Mujë Gashi**, caktohet anëtarë rezervë i cili do ta zëvendësojë anëtarin e rregullt të komisionit të ankesave në rast që paraqet konflikt interesi.
- Anëtarët e komisionit si nga pika 1 e këtij vendimi do të shqyrtojnë ankesat dhe do t'i vlerësojnë ato në përputhje me dispozitat ligjore.
- Komisioni punë e kryen në përputhje me dispozitat e Rregullores së MF Nr.04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, si dhe akteve të tjera pozitive në këtë fushë.
- Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.

Te njoftohen:

- Anëtarët e komisionit;
- Zyra kryetarit;
- Zyra e informimit;
- Arkivi.

Kryetari i Komunës

z. Zenun Elezaj